



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

“RIN-KRIJON”

"Konkursi Rinor për Zgjedhjet 2025" synon të fuqizojë rininë shqiptare për të kontribuar në procesin zgjedhor përmes punimeve krijuese. Duke nxitur krijimin e grafikave, videove dhe sloganeve, konkursi synon të amplifikojë zërat e rinisë, të promovojë vlerat demokratike dhe të rrisë ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen në zgjedhjet e vitit 2025.

Të gjitha materialet duhet të dërgohen tek adresa e postës elektronike:

info@kqz.gov.al

Fazat e Konkursit:

Faza 1: Eventi i Nisjes (16 Shtator 2024)

Faza 2: Faza e Promovimit të Konkursit (17 Shtator - 31 Tetor 2024)

Faza 3: Rishikimi i propozimeve dhe vendimi (1 Nëntor - 14 Nëntor 2024)

Një panel vlerësuesish do të analizojë propozimet dhe do të vendosë fituesit për çdo kategori. Paneli do të përbëhet nga përfaqësues të KQZ-së, OSBE PiA dhe Grupesh Këshillimore Rinore, të cilët do të vlerësojnë propozimet bazuar në kreativitetin, qartësinë e mesazhit dhe impaktin dhe rëndësinë për procesin zgjedhor.

Faza 4: Eventi i Mbylljes për Nominimin e Fituesve (19 Nëntor 2024)

Konkursi do të kulmojë me një event mbyllës më 19 Nëntor 2024. Ky event do të prezantojë punimet më të mira dhe do të përfshijë fjalime nga palët pjesëmarrëse nga OSBE PiA dhe KQZ. Programi do të përfshijë gjithashtu një performancë artistike, pasuar nga prezantimi i çmimeve për fituesit në çdo kategori. Çdo fitues do të marrë një çmim.

Çmimet:

- Fituesit e vendit të parë në çdo kategori do të marrin një çmim teknologjik, të përshtatur me natyrën e kategorisë. Çmimet e propozuara përfshijnë një Kindle (për fituesin e Sloganeve), një tabletë Wacom/Tabletë digjitale për dizajnin grafik ilustrativ dhe një kompleks për aksesore Vlogger/Kamera (për fituesin e videos së shkurtër zgjedhore).
- Fituesit e vendit të dytë dhe të tretë do të shpërblehen me një kupon dhuratash me vlerë deri në 50 EUR.

Kriteret e Vlerësimit për Materialet e Konkursit “RIN-KRIJON - Fuqizimi i të Rinjve në Procesin Zgjedhor 2025”

Përmbledhje e Përgjithshme: Kjo nismë synon të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në procesin zgjedhor të vitit 2025, duke u dhënë mundësinë të krijojnë grafika, video dhe slogane për fushatën ndërgjegjësuere të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Kriteret e mëposhtme do të përdoren për vlerësimin e materialeve të dorëzuara, me fokus te origjinaliteti, ndikimi i mesazhit, kreativiteti, dhe efektiviteti në përfshirjen e të rinjve.

1. Origjinaliteti dhe Kreativiteti (30%)

- **Shqyrtimi i Ideve të Reja dhe të Veçanta:** Materialet që dorëzohen duhet të dallohen për idetë dhe qasjet e reja, që nuk janë të kopjuara nga burime të tjera ose të frymëzuara nga materialet ekzistuese. Duhet të reflektojnë mendim të pavarur dhe krijimtari të lartë. Materialet që dorëzohen nuk duhet të jenë të gjeneruara nëpërmjet inteligjencës artificiale.
- **Qasja Inovative në Mesazh:** Vlerësohet përdorimi i elementeve të reja artistike, konceptuale dhe teknologjike, për t'i bërë materialet më tërheqëse dhe të paharrueshme. Materialet që ofrojnë një këndvështrim të ri në procesin zgjedhor do të kenë prioritet.

2. Përshtatshmëria e Mesazhit (25%)

- **Kuptueshmëria dhe Qartësia:** Mesazhi i materialit duhet të jetë i qartë, i thjeshtë dhe i lehtë për t'u kuptuar nga audiencia e synuar (të rinjtë dhe votuesit për herë të parë). Komunikimi i qëllimit të fushatës zgjedhore dhe rëndësia e pjesëmarrjes në zgjedhje duhet të përcillet qartë dhe pa keqkuptime.
- **Përputhshmëria me Tematikën e Zgjedhjeve:** Materialet duhet të përqendrohen në temën kryesore të fushatës, që është fuqizimi i të rinjve dhe përfshirja e tyre aktive në procesin demokratik. Përshtatshmëria e mesazhit me qëllimet e përgjithshme të KQZ-së për zgjedhjet e 2025-ës do të jetë një faktor i rëndësishëm.

3. Ndikimi dhe Efekti Emocional (20%)

- **Aftësia për të Gjeneruar Ndërgjegjësim:** Materialet duhet të kenë aftësinë të nxisin ndërgjegjësim për rëndësinë e zgjedhjeve në mesin e të rinjve. Mesazhet që arrijnë të ndërgjegjësojnë dhe motivojnë audiencën për të marrë pjesë aktive në procesin zgjedhor janë më të vlerësuara.
- **Ndikimi në Emocionet e Audiencës:** Vlerësohet aftësia e materialeve për të krijuar lidhje emocionale me audiencën, për të inspiruar dhe nxitur reagime pozitive, siç janë ndjenja e përgjegjësisë qytetare dhe përkushtimi për të marrë pjesë në zgjedhje.

4. Ndikimi në Të Rinj dhe Votuesit e Parë (15%)

- **Aftësia për të Angazhuar Të Rinjtë:** Materialet duhet të përqendrohen në angazhimin e të rinjve, veçanërisht votuesve të parë, në zgjedhje. Ato që ofrojnë ide dhe mesazhe që u flasin drejtpërdrejt përvojave dhe shqetësimeve të tyre kanë më shumë gjasa të kenë ndikim të qëndrueshëm.

- **Përshtatshmëria për Audiencën e Rinjve:** Përmbajtjet duhet të jenë të përshtatshme për shijet dhe interesat e të rinjve, duke pasur parasysh elemente të kulturës rinore, gjuhën, dhe kanalet e komunikimit që preferojnë (si rrjetet sociale dhe platformat digjitale).

5. Përfaqësimi Vizual dhe Estetika (10%)

- **Cilësia e Grafikës dhe Videove:** Materialet vizuale duhet të kenë një nivel të lartë të cilësisë artistike dhe teknike. Grafikët dhe videot duhet të jenë të qarta, me një përmbajtje të mirëorganizuar dhe një ekuilibër estetik mes ngjyrave, imazheve, dhe simboleve.
- **Koherenca dhe Mesazhi Vizual:** Elementet vizuale (grafika, dizajni, ngjyrat) duhet të jenë të koherente dhe të përforcojnë mesazhin kryesor të materialit. Një dizajn i pastër dhe i thjeshtë që tërheq vëmendjen e të rinjve është i preferuar.

6. Përshtatshmëria Teknike dhe Zbatimi në Praktikë (10%)

- **Aplikueshmëria në Platformat e Komunikimit:** Materialet duhet të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në platformat e ndryshme të komunikimit, si në mediat sociale, reklamën televizive, apo në ambiente publike. Aftësia për t'u përshtatur në formate të ndryshme dhe për të komunikuar në mënyrë efektive përmes tyre do të vlerësohet.
- **Shfrytëzimi i Teknologjive të Reja:** Materialet që shfrytëzojnë teknologjitë dhe trendet e reja në prodhimin e përmbajtjes vizuale, si animacionet ose elementet interaktive, do të konsiderohen si avantazh.

7. Respektimi i Rregullave dhe Udhëzimeve (5%)

- **Përmbushja e Kërkesave Teknike dhe Formale:** Materialet duhet të jenë në përputhje me qartësinë dhe forcën e mesazhit të kërkuar për pjesëmarrjen aktive në procesin zgjedhor. Çdo material që nuk respekton këtë udhëzim do të përjashtohet automatikisht nga procesi i vlerësimit.
- **Përmbajtja Etike dhe Ligjore:** Materialet duhet të jenë në përputhje me normat etike dhe ligjore të vendit. Nuk duhet të përmbajnë elemente diskriminuese, të pavërteta ose që nxisin dhunë apo urrejtje.

Përfundim: Konkursi i 2025-ës për fuqizimin e të rinjve në procesin zgjedhor synon jo vetëm të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje, por edhe të krijojë një platformë për të rinjtë që të ndajnë zërat dhe idetë e tyre për një demokraci më të fortë dhe më të përfshirë. Këto kritere do të ndihmojnë në zgjedhjen e materialeve që jo vetëm reflektojnë kreativitet dhe mesazhe të forta, por gjithashtu inspirojnë të rinjtë për të qenë qytetarë të përgjegjshëm dhe aktivë.

Të gjitha materialet e konkursit RIN-KRIJON duhet të dërgohen tek adresa e postës elektronike:

info@kqz.gov.al